



Periodiku AMF

I. Intervista të përfaqësuesve të AMF në kuadrin e krizës financiare globale

Në kuadër të temës aktuale, krizës financiare globale, ka patur një interesim të mediave të ndryshme në vend në lidhje me situatën financiare të tregut të sigurimeve.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II. 1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - shtator 2008

Në periudhën janar - shtator 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 5,396,633 mijë lekë, përkundrajt 4,482,339 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Vijon në faqen 2

II. 2 Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – shtator 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – shtator 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar"

Vijon në faqen 4

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III. 1 Pjesëmarrje në konferencën vjetore të Komitetit të Tregjeve në Zhvillim të IOSCO-s

Në datat 7-11 tetor, 2008 në Marrakesh, Marok, u zhvillua konferenca vjetore e Komitetit të Tregjeve në Zhvillim e IOSCO-s, e cila u mundësua nga Autoriteti i Tregut të Letrave me Vlerë të Marokut.

Vijon në faqen 5

III. 2 Pjesëmarrje në konferencën vjetore të IAIS

Në datat 14-17 tetor 2008, në Budapest, Hungari, përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, morën pjesë në konferencën vjetore të IAIS.

Vijon në faqen 6

III. 3 Pjesëmarrje në programin trajnues mbi zhvillimin, zbatueshmërinë dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit

Komisioni i Bursës dhe Letrave me Vlerë të SH.B.A në bashkëpunim me Bordin e Kapitalit të

Turqisë, organizuan në datat 20-24 Tetor 2008, në ambientet e Bursës së Stambollit, Turqi, një program trajnimi

Vijon në faqen 7

III. 4 Pjesëmarrje në trajnimin e avancuar për reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata

Gjatë periudhës 29 shtator deri më 17 tetor 2008, në Stokholm, Suedi, u zhvillua trajnimi i avancuar mbi reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata.

Vijon në faqen 8

III. 5 Pjesëmarrje në trajnimin për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe krijimin e dispozitave përkatëse të acquis-it në legjislacionin shqiptar

Njësia TAIEX pranë Komisionit Evropian dhe Bankës së Shqipërisë, organizoi në datën 24 tetor 2008, në ambientet e hotel "Tirana Internacional" trajnimin mbi lëvizjen e lirë të kapitalit dhe krijimin e dispozitave të acquis-it në legjislacionin shqiptar.

Vijon në faqen 9

III. 6 Vizitë pranë qendrës së informacionit të siguracioneve motorrike TPL – TRAMER.

Në datat 21-23 tetor 2008, në Stamboll, Turqi, përfaqësues të AMF, bënë një vizitë me qëllim studimin e sistemit të Regjistrimit të Dëmeve dhe të infrastrukturës së gjithë Qendrës.

Vijon në faqen 10

...*Vijon nga numri i kaluar*

IV. Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

Kapitulli 4(Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: "Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private") Programe dhe instrumenta për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj riskut dhe edukimit mbi çështjet e sigurimeve

Vijon në faqen 12

Në këtë numër:

Intervista të përfaqësuesve të AMF në kuadrin e krizës financiare globale **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **5**

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private **12**

Intervista të përfaqësuesve të AMF në kuadrin e krizës financiare globale

Në kuadër të temës aktuale, krizës financiare globale, ka patur një interesim të mediave të ndryshme në vend në lidhje me situatën financiare të tregut të sigurimeve. Përfaqësues të Autoritetit janë prononcuar në media në lidhje me situatën financiare në tregun e sigurimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ka ndjekur me kujdes zhvillimet në tregjet ndërkombëtare dhe në atë të brendshëm, duke konsideruar me kujdes çdo skenar të mundshëm.

Kryesisht tregu i sigurimeve ka qenë objekt i zhvillimeve pozitive dhe është karakterizuar nga një rritje e qëndrueshme. Gjendja financiare e tij vlerësohet e mirë, me ecuri të kënaqshme të treguesve të rentabilitetit, përmirësim të aftësive të tregut të sigurimeve për të mbuluar me kapital humbjet e mundshme nga përgjegjësitë e kontraktuara, si rrjedhojë e rritjes së kapitalit minimal në formën e fondit të garancisë, si dhe mjaftueshmëri kapitali mbi nivelin minimal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Tregu i sigurimeve është i mirëkapitalizuar dhe disponon kapital më se të mjaftueshëm për nivelin aktual të biznesit të sigurimeve në vend, që do të thotë, potencial të pashfrytëzuar për rritjen të mëtejshme të biznesit.

Politika e investimeve të shoqërive të sigurimit rregullohet nga rregulla strikte, të cilat janë përforcuar akoma në fillim të vitit 2008, ndërkohë që Autoriteti ndjek një politikë monitorimi dhe komunikimi të vazhdueshëm me tregun, me qëllim evidentimin e çdo lloj skenari të mundshëm që mund të ketë ndikim në tregun e sigurimeve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe

monitorimit të grupeve të huaja që kanë shtrirje në Shqipëri, konkretisht kompanitë austriake dhe greke. *Ndërkohë investimet që i përgjigjen detyrimeve ndaj policmbajtësve janë të vendosura brenda territorit të Shqipërisë, kanë një natyrë jo komplekse dhe nuk paraqesin ekspozim ndaj luhatjeve që tregjet ndërkombëtare po përjetojnë.* Politika e vlerësimit të tyre është tepër konservatore nga ana e Autoritetit, gjë që minimizon edhe riskun e luhatjeve ndaj vlerës së tregut vendas.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - shtator 2008

Në periudhën janar - shtator 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 5,396,633 mijë lekë, përkundrejt 4,482,339 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Kështu, tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 20.40% nga viti i kaluar, ku 89.71% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo - Jetës, ndërsa 10.29% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 32.78% të sigurimeve të Jetës dhe 19.55% të sigurimeve të Jo - Jetës.

Në periudhën janar - shtator 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 0.96%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo - Jetës u rrit në masën 64.65%.


Në periudhën janar - shtator 2008 u lidhën 508,026 kontrata sigurimi, përkundrejt 405,920 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të

vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo - Jetës kapi vlerën 467,581 nga 377,997 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli “Sigurimi i shëndetit” ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 48,473 kontrata ose në masën 65.34% më shumë se janar - shtator 2007.


Vlen të përmendet rritja në masën 44.84% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 40,445, nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” pati një rritje prej 5,989 kontrata ose 47.83%, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - shtator 2008, ishte rreth 1,086,516 mijë lekë, ose 6.79% më shumë se në janar - shtator të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 866,114 mijë lekë, apo 82.11% të totalit. Në portofolin "Kartoni Jeshil" kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 13.22% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 26.44 % krahasuar me 9 mujorin e parë të vitit 2007.

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto për periudhën janar – shtator 2008 (Jeta dhe Jo - Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – shtator 2008 (Jo - Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - shtator

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2007	2008
<i>Periudha janar - shtator</i>		
A) Sigurim i Jetës	287,136	381,256
B) Sigurim i Jo - Jetës	4,195,203	5,015,377
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,970,773	2,999,313
b) Sigurimi Vullnetar	1,224,430	2,016,064
TOTAL	4,482,339	5,396,633

II. Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – shtator 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – shtator 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” me **39.56%** dhe vendin e dytë “Blerje në tregun primar” me **31.30 %** kundrejt volumit të përgjithshëm.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë nëntëmujorit të vitit 2008 u dominua në masën **97.37%** nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe **2.63%** nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve individëve apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individë me **98.22 %** të totalit të transaksioneve në këtë treg.


Dy grupet e transaksioneve “B” dhe “C”

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** ka pësuar një ulje prej 131.74 milionë lekë ose **1.86%** krahasuar me janar – shtator 2007 dhe numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një ulje prej **12.01%**.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** ka pësuar një ulje prej 14.42 milionë lekë ose **3.49%** krahasuar me janar – shtator 2007 ndërsa numri i transaksioneve të këtij lloji ka pësuar një rritje prej **7.68%**.

Kjo ulje në vlerë absolute të totalit të transaksioneve të llojit B dhe C në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007, kap vlerën 146.16 milion lekë ose **1.95%**.

Letra me vlerë të qeverisë Janar - Shtator 2008



Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2007 - 2008

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2007	2008	'08/'07-1
Periudha janar - shtator			
Letra me vlerë të Qeverisë			
B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	7,071.24	6,939.50	(1.86)
Individë	6,934.74	5,426.05	(21.76)
Persona juridikë	136.50	1,513.45	1,008.76
C. Blerje nga individët para afatit të maturimit	413.23	398.81	(3.49)
Individë	363.42	385.65	6.12
Persona juridike	49.81	13.17	(73.57)

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të Komitetit të Tregjeve në Zhvillim të IOSCO-s



Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF

Në datat 7-11 tetor, 2008 në Marrakesh, Marok, u zhvillua konferenca vjetore e Komitetit të Tregjeve në zhvillim e IOSCO-s, e cila u mundësua nga Autoriteti i Tregut të Letrave me Vlerë të Marokut.

Komiteti i Tregjeve në Zhvillim (EMC) përfshin rreth 80 autoritete të tregut të letrave me vlerë nga vendet në zhvillim, është një komitet i specializuar i IOSCO-s, në kuadrin e Komitetit Ekzekutiv, i cili përfshin Komitetin e Tregjeve të Zhvilluara dhe Komitetin e Tregjeve në Zhvillim, në të cilin bën pjesë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

EMC, luan një rol kritik në zhvillimin e këtyre tregjeve, ndihmon në shkëmbimin e informacionit ndërmjet enteve rregullatore, vrojton dhe jep asistencë për ecurinë e firmosjen e memorandumit multilateral të IOSCO-s, promovon zhvillimet dhe vlerëson efikasitetin e tregjeve në zhvillim të letrave me vlerë, si dhe strategjitë e këtyre tregjeve duke ndërtuar parime dhe standarde, përgatitur programe për anëtarët, me qëllim lehtësimin e



Konferenca vjetore e Komitetit të Tregjeve në Zhvillim. Marok 2008

shkëmbimit të informacionit, teknologjisë, ekspertizave dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Në këtë konferencë, lektorë të niveleve të larta, diskutuan problemet që përfshijnë tregjet në zhvillim në kuadrin e globalizimit të ekonomisë dhe të krizës ekonomike që ka prekur botën.

Gjatë ditës së parë, u mbajt Mbledhja e Bordit të Këshillimit të EMC si dhe u mbajtën mbledhjet e grupeve të punës, ku u diskutua dhe u dha informacion mbi:

- o Zbatueshmërinë dhe shkëmbimin e informacionit.
- o Zhvillimin dhe rezultatet e mbledhjes së qershorit 2008, që u mbajt në Turqi, për paketën rregulluese.
- o Bashkëpunimin midis grupit të punës në implementimin e MMoU.
- o Fit & Proper.
- o Ngritja e një grupi monitorimi, si një mekanizëm midis autoriteteve të letrave me vlerë dhe IASC Foundation.

Gjatë ditës së dytë, u diskutua mbi:

- o Direktivat strategjike të IOSCO-s.
- o Raportin mbi implementimin e MMoU-së.
- o Raportin për implementimin e parimeve të IOSCO-s.
- o Raportin nga Mr. Greg Tanzer, Sekretar i Përgjithshëm i IOSCO-s, për programet e

asistencës dhe trajnimeve të IOSCO-s.

Në këtë mbledhje u prezantua krijimi i Task Force, për lehtësimin e krizës ekonomike që ka përfshirë botën, kryesisht për tregjet në zhvillim. Kjo Task Force do të fokusohet kryesisht në produktet financiare të strukturuar.

Në fund të ditës së dytë, u raportua nga të gjithë kryetarët e grupeve të punës së IOSCO-s.

Dita e tretë u zhvillua në seancë plenare në Pallatin e Kongreseve të Marrakeshit. Në të mori pjesë Ministri i Ekonomisë dhe Financave të Marokut, Z. Salah Eddine Mezouar. Fjalimi i tij u përqëndrua në zhvillimet ekonomike globale, krizën ekonomike që po kalon bota, sfidat e saj, ndryshimet klimaterike, përballimin e kësaj krize botërore dhe përgatitjen e tregjeve në zhvillim për këto sfida.

Në panelet e Tij u diskutua mbi:

1. "IPO challenges", Sfidat e shoqërive të listuara në bursë në tregjet në zhvillim.
2. Aksesi i SME-s (Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) në treg.
3. Edukimin e investitorëve, si qëllim për mbrojtjen e investimeve.
4. Përgatitjen e tregjeve në zhvillim për globalizimin.

Të gjitha diskutimet ishin të niveleve të larta dhe u vlerësuan nga të pranishmit.

II. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të IAIS

Në datat 14-17 tetor 2008, në Budapest, Hungari, përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, morën pjesë në konferencën vjetore të IAIS.

Kjo konferencë ishte një ngjarje e veçantë për nga rëndësia, ku anëtarët me të drejta të plota, vëzhguesit dhe profesionistët në fushën e sigurimeve nga e gjithë bota, shkëmbyen mendime mbi çështje të rëndësishme për mbikëqyrësit në fushën e sigurimeve dhe pjesëmarrësve në këtë treg. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, morri pjesë në këtë aktivitet si anëtar me të drejta të plota.

Tema mbi të cilën u zhvillua konferenca vjetore e IAIS 2008 ishte: *Sigurimet dhe globalizimi i shërbimeve financiare; Sfidat për rregullimin dhe mbikëqyrjen mbarëbotërore.*

Gjatë konferencës u trajtuan dhe u diskutuan çështje të tilla si:

o Bashkëpunimi dhe transparencja në situatë krizash (këtu u tregua rëndësia e bashkëpunimit efektiv ndërmjet mbikëqyrësve globalë nga njëra anë dhe mbikëqyrësve e industrisë nga ana tjetër).

o Mbikëqyrja e grupeve në aktivitetin e sigurimeve (këtu u shqyrtua shkalla e përhapjes së aktivitetit të siguresve që operojnë brenda një strukture grupi, tiparet e një sistemi mbikëqyrje që mund t'i përshtatet më mirë këtyre tregjeve).

o Pasojat e standardeve të ardhshme për aftësinë paguese (këtu u shqyrtuan anët pozitive dhe rreziqet që përfshin lëvizja drejt një mbikëqyrje me bazë parimesh dhe një mbështetje më e madhe mbi menaxhimin e riskut të shoqërisë e me pak mbështetje në rregullat sasiore), etj.

Konferenca vjetore bëri të mundur që të diskutoheshin edhe sfidat që paraqet situata aktuale e tregut. Duke analizuar arsyet që çuan drejt krizës, vëmendje e veçantë iu kushtua përgjegjësive që duhet të mbajnë rregullatorët. Kështu u theksua se rregullatorët duhet t'i përgjigjen sfidave në tregjet e tyre, duke qenë përgjegjës që masat e marra në tregjet e tyre

lokale të mos kenë pasoja negative në tregjet e tjera, ose në sektorët e tjerë të ekonomisë.

Konferenca vjetore e 15-të e IAIS, shpalli disa rezoluta, ku ndërmjet të tjerave u aprovuan dhe dokumentet e mëposhtme:

- o Standardet e administrimit të riskut të sipërmarrjeve për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për qëllimet e aftësisë paguese.
- o Udhëzime të administrimit të riskut të sipërmarrjeve për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për qëllimet e aftësisë paguese.
- o Standardet e strukturës së kërkesave rregullatore për kapitalin.
- o Udhëzime të strukturës së kërkesave rregullatore për kapitalin.
- o Standardet për përdorimin e modeleve të brendshme rregullatore për kapitalin.
- o Udhëzime për përdorimin e modeleve të brendshme rregullatore për kapitalin.

Në këtë konferencë u theksua gjithashtu, rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve të sigurimeve, dhe kjo praktikisht u mbështet nga pranimi që IAIS u bëri anëtarëve të rinj për të marrë pjesë në këtë organizatë.

III. Pjesëmarrje në programin trajnues mbi zhvillimin, zbatueshmërinë dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit

Komisioni i Bursës dhe Letrave me Vlerë të SH.B.A në bashkëpunim me Bordin e Kapitalit të Turqisë, organizuan në datat 20-24 Tetor 2008, në ambientet e Bursës së Stambollit, Turqi, një program trajnimi një javor, “Mbi



Trajnim: “Mbi zhvillimin, zbatueshmërinë dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit.”

zhvillimin, zbatueshmërinë dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit.”

Ky program ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregjeve të kapitalit, të prezantuara këto nëpërmjet leksioneve, tavolinave të rrumbullakëta dhe studimit të rasteve të ndryshme.

Ekspertë të ndryshëm të Komisionit të Bursës dhe Letrave me Vlerë të SH.B.A dhe Bordit të Kapitalit të Turqisë, si dhe përfaqësues të rajonit, ndanë eksperiencat e tyre për zhvillimin dhe zbatueshmërinë në tregun e kapitalit dhe mbikëqyrjen e pjesëmarrësve në treg.

Ky program u fokusua në zgjidhjen e krizave dhe abuzimeve të tregut, duke vënë theksin në të përbashkëtat dhe dallimet e sistemeve rregullatore nëpër botë dhe duke theksuar praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Ekspertët dhanë shembuj konkretë nga e gjithë bota, të abuzimit dhe të paefektshërisë së tregut të kapitalit, për të studiuar të gjitha mjetet rregullative dhe ligjore që duhen të adresohen nga të gjithë rregullatorët e tregut të kapitalit.

Gjatë javës u bënë prezantime nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm si: Dr. Robert M. Fisher, Z. Timothy L. Warren, Z. Daniel M. Gray, Z. Kurt Gresenz

dhe Zj. Rina Hussain, përfaqësues të Komisionit të Bursës dhe Letrave me Vlerë të SH.B.A si dhe përfaqësues të Bordit të Kapitalit të Turqisë, si Z. Huseyin Erkan, Dr. Turan Erol, Zj Tuba Ertugay Yildiz, etj., të cilët ndanë eksperiencën turke në fushën e tregut të kapitalit.

Ndër temat e ndryshme që u diskutuan, theksi u vendos kryesisht në sfidat e rregullimit të tregjeve të reja të kapitalit, investigimi i manipulimit të tregut, kooperimi në kuadër të zbatueshmërisë ndërkombëtare, procesi i mbikëqyrjes i komisionerit/agjentit të shitjes, vlerësimi i riskut gjatë procesit të inspektimit, etj.

Në këtë program morën pjesë përfaqësues nga 40 vende të ndryshme të botës dhe në fund të tij u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.

IV. Pjesëmarrje në trajnimin e avancuar për reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata

Gjatë periudhës 29 shtator deri më 17 tetor 2008, në Stokholm, Suedi, u zhvillua trajnimi i avancuar mbi reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata. Ky trajnim u mundësua falë asistencës së SIDA-s, Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit, Suedi dhe u organizua nga Bicon BA, Njësia për Trajnimin dhe Konsulencën në Sigurime, Stokholm.

Zhvillimi i trajnimit u nda në tre javë, ku në secilën prej tyre u trajtuan të tre kolonat e sistemit të pensioneve.

Java e parë u hap me një prezantim të sistemit suedez të pensioneve, ku pjesëmarrësve ju ofrua një pamje e gjerë e faktorëve historik

dhe ekonomik që kishin ndikuar në themelimin e një sistemi të tillë pensionesh. Një vëmendje ju kushtua shumë edhe kuadrit ligjor, i cili ishte strukturuar në mënyrë të tillë që mbulonte më së miri të tri shtyllat e pensioneve me nga një ligj të veçantë.

Shtylla e parë, në përputhje me të gjitha praktikatat ndërkombëtare, përbëhej nga sigurimet shoqërore, të cilat administroheshin dhe mbikëqyrreshin nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore. Shtylla e parë e pensioneve mbështetej në NDC, sistem me kontribute nacionale të përcaktuar, ku pensioni i ardhshëm i të gjithë kontribuesve përcaktohet nga kontributet e akumuluar gjatë periudhës së pjesëmarrjes në skemë. Një sistem i tillë i mbledhjes së kontributeve ishte zbatuar në Suedi rreth viteve '60 dhe ka rezultuar shumë i efektshëm si në anën sociale ashtu edhe në atë ekonomike.

Pjesë e rëndësishme e kolonës së parë ishte ngritja e një instituti të ri suplementar me sigurimet shoqërore i quajtur PPM (Permium Pension Authority) i cili administrohej në mënyrë të pavarur si strukturë më vete nga sigurimet shoqërore.

Ky institucion administron në llogari individuale, plotësisht të kapitalizuara, 2.5% të të gjithë kontributit të destinuar për sigurimet shoqërore. Kontribuesve u jepej mundësia e investimit të këtyre kontributeve në 2500 fonde të veçanta, të cilat administroheshin nga PPM. Roli i këtij institucioni ishte menaxhimi i këtyre kontributeve dhe orientimi i kontribuesve në lidhje me portofolet ka ata mund të investonin. Ky sistem suplementar brenda kolonës së parë jepte një mundësi reale për rritjen e nivelit të pensionit për të gjithë pjesëmarrësit në skemë.

Java e dytë e trajnimit ju kushtua tërësisht kolonës së dytë, skemës suplementare të pensioneve. Kjo skemë mundësonte pension pleqërie për të gjithë të punësuarit në sektorin

publik ose privat dhe funksiononte falë së ashtuquajturës kontratë kolektive. Kontrata kolektive përfaqësonte një marrëveshje të lidhur midis organizatave të punëtorëve dhe atyre të punëdhënësve dhe rregullonte çështje në lidhje me pagën, pensionin, pagesën e kontributeve, etj. Hyrja e të punësuarve në kolonën e dytë të pensioneve mundësohej nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes kolektive, të cilat sipas sistemit Suedez ishin dy llojesh: a) marrëveshje për jakat e bardha (nëpunësit shtetëror) dhe b) marrëveshje për jaka blu (punëtorët). Në krijimin dhe zbatimin e kolonës së dytë, një rol kryesor kishin sindikatat e secilës palë. Shteti shihej si një rregullator i kësaj skeme.

Në javën e tretë të trajnimit u mbajtën leksione rreth kolonës së tretë të pensioneve. Kjo kolonë zhvillohej nga bankat dhe shoqëritë e sigurimit, të cilat licencoheshin për një shërbim të tillë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kishte një rol të madh në mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara për të operuar në kolonën e tretë. Kjo mbikëqyrje realizohej nëpërmjet të ashtuquajturit sistem i dritave të trafikut. Për çdo shoqëri të veçantë bëhej një analizë e detajuar e gjendjes financiare dhe e rezervave të detyrueshme dhe në fund të analizës sistemi klasifikonte shoqëritë të cilat paraqesnin rrezik, me dritë të kuqe dhe ato të cilat kishin një gjendje të stabilizuar financiare, me dritë jeshile. Për një transparencë më të madhe dhe një orientim sa më të mirë të konsumatorit, në mënyrë të përmbledhur, këto rezultate bëheshin publike.

Pjesë e rëndësishme e këtij trajnimi ishte dhe puna në grup, ku çdo shteti ju ngarkua detyra e zhvillimit dhe e prezantimit të një projekti në fushën e pensioneve. Grupet e punës u asistuan nga një pedagog për përcaktimin e temës që do të trajtohej dhe objektivat kryesore që do të zhvilloheshin. Në këtë pjesë të trajnimit, grupi

shqiptar u prezantua me temën: “Analiza dhe prognoza e shtyllës së parë të pensioneve”.

Gjatë trajnimit pati edhe një numër të madh vizitash në institucionet kryesore në fushën e sigurimeve si p.sh në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në shoqërinë më të madhe të sigurimeve të jetës dhe jo-jetës “Nordea” si dhe një vizitë në zyrat e Parlamentit.

Në fjalën mbyllëse, u nënvizua frytshmëria dhe efektiviteti i të tria javëve, si në analizën e sistemit Suedez ashtu edhe në marrjen e një praktike të vlefshme për vende si Shqipëria, të cilat po mundohen të reformojnë sistemin ekzistues të pensioneve në kuadër të zbatimit të një sistemi modern, i cili duhet të jetë financiarisht i qëndrueshëm dhe shoqërisht i pranueshëm.

Në fund të këtij trajnimi u shpërndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit.

V. Pjesëmarrje në trajnimin për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe krijimin e dispozitave përkatëse të “acquis” në legjislacionin shqiptar

Njësia TAIEX pranë Komisionit Evropian dhe Bankës së Shqipërisë, organizoi në datën 24 tetor 2008, në ambientet e hotel “Tirana Internacional” trajnimin mbi lëvizjen e lirë të kapitalit dhe krijimin e dispozitave të acquis-it në legjislacionin shqiptar.

Qëllimi i këtij takimi ishte asistimi dhe njohja e pjesëmarrësve me dispozitat ndërkombëtare për



lëvizjen e lirë të kapitalit si dhe mënyrën e zbatimit të tyre në legjislacionin shqiptar. Njohja dhe zbatimi i direktivave të Bashkimit Evropian është një detyrim që rrjedh për Shqipërinë nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Pjesëmarrësve në këtë trajnim ju ofrua një pamje e gjerë e kuadrit ligjor në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, si një element i rëndësishëm në zhvillimin e vendeve të rajonit. Gjithashtu u nënvizuan hapat e reformave (që janë në proces dhe duhen ndërmarrë) në Shqipëri për të siguruar trajtim të barabartë mes shoqërive shqiptare dhe atyre të huaja, për të lehtësuar fillimin e veprimtarive ekonomike në territorin shqiptar nga shoqëri dhe shtetas komunitarë, si dhe eliminimin e barrierave ligjore apo administrative, me qëllim lehtësimin e shërbimeve.

Në takim ishin të ftuar lektorë nga vende të ndryshe të Europës.

Prezantimi i parë u mbajt nga Z. Moreland, anëtar i Parlamentit Evropian. Në prezantimin e tij, Z. Moreland, theksoi rëndësinë e përmbushjes së angazhimeve reciproke të vendeve anëtare, në kuadër të zbatimit të *acquis communautaire* si kusht esencial për funksionimin e këtij tregu unik.

Prezantimet e radhës u mbajtën nga lektorët, Z. Martzanis dhe Z. Varis, ku analizuan pjesë të ndryshme të direktivës 88/361/EEC të 24 korrikut 1988.

Rëndësia e këtij takimi konsistonte jo vetëm në njohjen me legjislacionin evropian në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit por edhe në ofrimin e një mundësie reale për zbatimin e këtyre dispozitave në legjislacionin shqiptar.

VI. Vizitë pranë qendrës së informacionit të sigurimeve motorrike TPL – TRAMER.

Në datat 21-23 tetor 2008, përfaqësues të AMF, bënë një vizitë në Stamboll, Turqi, me qëllim studimin e sistemit të Regjistrimit të Dëmeve dhe të infrastrukturës së gjithë Qendrës TRAMER.

TRAMER, është një qendër informatike ku mbledhen të dhëna për sigurimin e detyrueshëm motorrik MTPL dhe të dhëna mbi dëmet, të shkaktuara nga policat e lëshuara në këtë portofol. Kjo qendër ishte në varësi të Shoqatës së Siguruesve të Turqisë, por u shërbente dhe palëve të treta, ku përveç enteve shtetërore, shërbime të mundshme mund të kishin dhe konsumatorët e thjeshtë apo policëmbajtësit. Ndër avantazhet e këtij sistemi mund të përmendet fakti që kjo qendër komunikonte me sisteme të tjera online, si regjistrin e automjeteve, personave si dhe regjistrin e enteve të tjera, të taksave, etj.

Sistemi kishte dhënë rezultate të mira në uljen e numrit të të pasiguarve, në transparencë më të madhe kundrejt policëmbajtësve ose të dëmtuarve duke ulur dhe kostot e trajtimit të çështjeve, si dhe duke vendosur një standard, si në terma kohore por dhe në terma proceduriale. Sistemi gjithashtu zbatonte në mënyrë korrekte dhe sistemin Bonus-Malus në sigurimin motorrik. TRAMER udhëhiqej nga një BORD ku anëtar ishin përfaqësues nga kompanitë që operonin në këtë treg.

Vizita pranë zyrave të TRAMER, ishte e organizuar në formën e një takimi një ditor të formës pyetje-përgjigje. *Synimi kryesor i këtij takimi ishte mbledhja e sa më shumë të dhënave teknike, statistikore, operacionale apo dhe legjislative mbi eksperiencën e shtetit turk në zbatimin e regjistrimit të dëmeve.*

Përfaqësuesit e AMF, u takuan me z. Selçuk Ozhen, të cilit ju paraqit një tablo e Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik si dhe tre fazat e zbatimit të tij. Realizimi i fazës së parë (Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik), statusi, si dhe eksperiencia e përfutur nga kjo fazë; projekt-ideja e fazës së dytë, e cila është Regjistri i Dëmeve; si dhe vizioni i AMF për fazën e tretë, Sistemi Bonus-Malus, si hap i natyrshëm pas zbatimit dhe popullimit me të dhëna, të Regjistrimit të Dëmeve.

Më pas, specialistë të kësaj qendre bënë një prezantim të rrjedhës logjike të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik, duke bërë analogji dhe me TRAMER. Fillimisht u diskutuan problematikat e lidhura me fazën e parë, që është Regjistri i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik. Problematika kryesore e cila vazhdonte të hasej ende në TRAMER, ishte niveli i papastërtisë të të dhënave.

Specialistët konsistonin në:

- o Zhvillues Sistemi.
- o Analistë të Dhënash/Aktuare.
- o Zhvillues Raportesh.

Në lidhje me fokusin kryesor të vizitës, pra Regjistrin e Dëmeve, në bazë të sistemit të Dëmeve të përdorur nga TRAMER, u trajtuan pikat si dhe u nxorën përfundimet e mëposhtme:

- o U kërkua njohja me pjesët e sistemit të tyre të trajtimit të dëmeve.
- o Procesi i interagimit dhe i rrjedhjes së të dhënave: Shoqëri → Dosje Dëmi → Transferim FTP → Tramer → 1 herë në ditë check/store procedurë me data validation => ruajtje në tabela në Bazën e të Dhënave me të dhënat korrekte e të gabuara → të dhënat e gabuara (në se ka) ju komunikoheshin me email shoqërive për rishqyrtim dhe ridërgim.

o *Struktura e të dhënave në lidhje me dëmet:* Kjo strukturë e cila u ilustrua nga zhvilluesi i sistemit ishte shumë e gjerë, me më tepër të dhëna se ato të parashikuara nga ne si për mjetin që shkakton dëmin (ne kemi parashikuar vetëm targën) ashtu edhe për palët e përfshira. O U dhanë shembuj të formateve të raporteve të ndryshme mbi dëmet në bazë shoqërisht, gjendjes së dëmit, tipit të dëmit, tipit të pagesës, datës, etj.

o E njëjta ndërfaqe e aksesuar nga 'brenda' mundësonte vëzhgimin e dosjes së dëmit të lidhur me policën.

o Nuk ekzistonte një ndërfaqe e menaxhimit vetëm të sistemit të dëmeve.

Pas prezantimit të sistemit të TRAMER, u prezantua projekti i sistemit tonë të dëmeve, i cili ka shumë ngjashmëri por dhe ndryshime me atë të TRAMER-it. U diskutuan anët pozitive të zgjidhjes sonë.

Më pas u kërkuan referencat ligjore, si dhe rregulloret e ndryshme në lidhje me regjistrin.

Në lidhje me sistemin Bonus-Malus dhe zbatimin në Turqi u dhanë përfundimet e mëposhtme:

o Dëmet integroheshin direkt me sistemin Bonus-Malus, duke kondicionuar vlerën e policës në një sistem prej 7 shkallësh, ku shkallët 1-3 përbënin zonën Malus në rend zbritës, shkalla 4 përbënte tarifën normale dhe shkallët 5-6 përbënin zonën Bonus në rend rritës.

o Primi i aplikuar i policës kondicionohej nga zona gjeografike e prerjes së saj.

o Primi i policës përcaktohej nga ana e TRAMER në një interval vlerash. Më pas primi i saktë zgjidhej nga vetë shoqëria.

o Vlera e policës NUK kondicionohej nga mosha, vitet e patentës, M/F, etj.

...Vijon nga numri i kaluar

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

(Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: "Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private")

Kapitulli 4: Programe dhe instrumenta për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj riskut dhe edukimit mbi çështjet e sigurimeve

Interneti është shndërruar në një kanal tjetër informimi, për të bërë krahasime, gjetur këshilla të specializuara dhe përdoret nga personat përdorues të internetit, si dhe organizma privatë në shumicën e vendeve të OECD⁵. Shumica e autoriteteve mbikëqyrëse ose ministritë e përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në rregullimin e sektorit të sigurimeve, kanë një faqe elektronike dhe zakonisht kanë dhe nga një nënfaqe⁶ ë i kushtohet informacionit për konsumatorin dhe/ose edukimit, duke siguruar informacion mbi produkte, sigurues dhe rregullatorë (shiko Tabelën 4.1). Gjithashtu, industria e sigurimeve dhe shoqatat e konsumatorëve janë duke përdorur më gjerësisht mundësitë e ofruara nga interneti. Ajo çka është tërheqëse e internetit, është mënyra e sigurimit të një informacioni gjithëpërfshirës tek konsumatori, në mënyrë interaktive dhe duke krahasuar produktet nga sigurues të ndryshëm, ndërkohë duke ja përshtatur dhe profilin të konsumatorit.

Disa nga autoritetet dhe organizmat e tjerë, veçanërisht avokatët e popullit dhe shoqatat e konsumatorëve, vënë në dispozicion gjithashtu

qendra telefonike dhe pika informacioni⁷.

Kutia 4.1. Faqe elektronike të selektuara
Në Meksikë, CONDUSEF është caktuar me detyrën e promovimit të edukimit financiar, e cilësuar si një nga mënyrat e parandalimit, duke bërë të mundur që konsumatorët të kuptojnë thelbin e kontratave të paqarta ose transaksioneve të dyshimta. Nëpërmjet faqes së saj elektronike¹, komisioni shpjegon llojet e ndryshme të kontratave të sigurimit dhe mbulimin e propozuar nga tregu i sigurimeve. Ai gjithashtu siguron informacion rreth agjentëve në sigurime dhe procedurat e miratimit për ndërmjetësit, së bashku me tabela të cilat krahasojnë, ndërmjet të tjerave, çmimet për sigurimin e mjeteve motorike dhe shëndetit, risqe të sigurueshme dhe përjashtimet. CNSF-ja, rregullatori i shërbimeve financiare, ka gjithashtu një faqe elektronike² që siguron informacion dhe të dhëna rreth situatës së kompanive të sigurimit.

Në Itali, një pjesë e faqes³ të ISVAP, i është kushtuar informacionit për konsumatorin, lidhur me sigurimin e jetës dhe sigurimin e detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL). Pjesa që i kushtohet sigurimit të jetës përfshin një guidë, e cila i siguron konsumatorëve një informacion të detajuar rreth veçorive kryesore të këtyre kontratave në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.

Në Spanjë, faqja elektronike⁴ e DGSFP, përfshin informacion gjithëpërfshirës për konsumatorët mbi rregullimin ekzistues të tregut të sigurimeve, informacion mbi industrinë (sigurues, ndërmjetës dhe kanalet e shpërndarjes). Informacioni mbi mbulimin e siguruar nga CCS, jepet nëpërmjet faqes së saj elektronike⁵.

Shoqata Kanadeze për Sigurimin e Jetës dhe Shëndetit ka krijuar një nënfaqe në portalin⁶ e saj, duke ofruar asistencë për konsumatorët dhe duke siguruar gjithashtu një informacion,

në formën e një guide dhe tabelave, e asistencë të personalizuar online ose nëpërmjet telefonit.

Në SHBA, faqja elektronike⁷ e NAIC organizon të ashtuquajturën java e “Bëhu i ditur rreth sigurimeve”, i cili organizohet në baza vjetore. Kjo është një mundësi për konsumatorët për të testuar dijet e tyre rreth tipeve të ndryshme të policave (p.sh motorike, jete, shtëpie dhe shëndeti), për të rishikuar nevojat e tyre për mbulim në sigurim dhe për të vlerësuar policat e tyre aktuale, për të marrë këshilla rreth anulimit apo ndryshimit të një police dhe për të marrë një informacion gjithëpërfshirës rreth produkteve, terminologjisë mbi sigurimet, siguruesit, dhe kështu me rradhë. Nënfaqja gjithëpërfshirëse e NAIC, që i kushtohet konsumatorëve (InsureU⁸), gjithashtu i siguron atyre këshilla/paralajmërimi kyçe (krahaso/bli përreth, merr informacion mbi kompaninë, vlerëso nevojat e secilit njëherë në vit), vlerëson nevojat sipas mënyrës së jetesës dhe ofron guidë për çdo lloj sigurimi, si dhe gjithashtu ofron pyetësorë dhe trajnime për të rritur kapacitetet dhe njohuritë e konsumatorëve mbi riskun dhe sigurimin.

1. www.condusef.gob.mx

2. www.cnsf.gob.mx

3. www.isvap.it

4. www.dgsfp.meh.es

5. www.conorsegueros.es

6. www.clhia.ca

6. www.clhia.ca

7. www.naic.org/consumer_home.htm

8. www.insureuonline.org

3. Programet e vlerësimit

Puna kërkimore në ndikimin e programeve për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj riskut dhe edukimi i aftësitë mbi sigurimet, konsiderohen nga pjesa më e madhe e vendeve, si thelbësore për shmangien e shpenzimeve të panevojshme dhe për sigurimin e një përshtatjeje e

rregullimi sa më të mirë të masave të politikave të reja që ndërmerren. Studimi i eksperiencës së OECD – së, gjithashtu sugjeron që për kohët që jemi, analiza të vogla duhet të ndërmerren mbi atë se si arrihet zbatimi i programeve⁸.

Ndërgjegjësimi mbi nevojën e edukimit mbi sigurimet është relativisht i ri. Si rrjedhim, pak programe gjithëpërfshirëse, të cilat koordinojnë iniciativat e aktorëve kryesorë të lidhura me edukimin mbi sigurimet, janë prezantuar dhe kur ato ekzistojnë, janë shumë të reja për t'u vlerësuar. Për shembull, në Hollandë, është menduar që një organizëm i pavarur kërkimor të masë efektivitetin e një fletëpalosjeje me informacion financiar (përfshirë sigurimet) pas një periudhe prej dy vjetësh. Rregullimi i shërbimeve financiare dhe roli i tyre këshillues do të jetë gjithashtu i vlerësuar pas një periudhe prej pesë vjetësh. Në mënyrë të ngjashme, në MB programi gjithëpërfshirës “Ngritja e aftësive financiare” dhe ndikimi i saj duhet të vlerësohet pas katër deri pesë vjetësh. Janë planifikuar vlerësime të rregullta të asaj, nëse ka përfitime nga çdo element i programit, si dhe publikimi në baza të rregullta të raporteve të progresit në mënyrë që të gjithë aktorët të vërejnë diferencën që po sjell programi.

Disa lloje të përdorshme vlerësimi, nëse jo ndikimi të programeve, sigurohen shpesh nga regjistrimi i numrit të përdoruesve të faqeve elektronike të posaçme, të ngritura nga autoritetet rregullatore të sigurimeve, p.sh në Izrael, efektiviteti i informacionit dhe fushatat e mediave lidhur me krijimin e faqes elektronike të komisionit të sigurimeve (i përfshirë në faqen elektronike të Ministrisë së Financave) monitorohet nëpërmjet numrit të vizitorëve në këtë faqe. Shifrat tregojnë një rritje në përdorimin e kësaj faqe, sidomos kur kombinohet me një reklamë të saj nga media (kryesisht nëpërmjet një transmetimi në radio). Në mënyrë të ngjashme, në SHBA, programi InsureU, i krijuar nga NAIC, është duke u monitoruar nëpërmjet numrit të përdoruesve të kësaj faqeje dhe numrit të pjesëmarrësve në

konkurset e propozuara në këtë faqe.

Shënime:

5. Megjithatë, duhet të theksohet, se aksesit i popullatës në internet mbetet i limituar duke përfshirë dhe vendet OECD e në mënyrë të dukshme për segmentet e deprivuara të popullsisë.

6. Për shembull, në Belgjikë, Francë, Gjermani, Izrael, Itali, Meksikë, Kore të Jugut, Spanjë, Zvicër, MB dhe SHBA.

7. Për shembull, krijimi nga DGSFP të Njesisë për Mbështetjen e Publikut në Spanjë.

8. Shembuj të tjerë të vlerësimit të qëllimit të limituar mund të përmenden, në Japoni, p.sh, ku AMF merr një opinion të votuar nga mësues lidhur me manualët e shpërndara tek studentët. Në mënyrë të ngjashme, Instituti Japonez për Sigurimin e Jetës dhe Shoqata për Sigurimin e Përgjithshëm të Japonisë, ndër mori vlerësime pasuese të programeve të tyre të mëparshme. Veç kësaj, në MB, Departamenti i Punës dhe Pensioneve ka mandatuar ECOTEC Research and Consulting Ltd. me qëllim rishikimin e dispozitës aktuale dhe efikasitetin e edukimit financiar në MB (detaje të kësaj pune dhe rezultatet mund të gjenden në www.dwp.gov.uk/publications, Informed Choices for working and savings). Një audit i burimeve për edukimin financiar dhe ndër të tjera të aftësive për mësimdhënie tek të rriturit, gjithashtu u ndër mor nga Basic Skills Agency (shikoni www.money-bsa.uk).

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, A. Dervishi, E. Basha,
E. Sherri, L. Lloji, R. Eltari, S. Zalta,
Dh. Hazbiu, E. Kokona

